

Para	SKK 13 “AKTIVET BIOLOGJIKE DHE MARRËVESHJET KONCESIONARE” – PËRDITËSUAR (2023)
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objekti i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 13 <i>Aktivet Biologjike dhe Marrëveshjet koncesionare</i> (SKK 13) miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga ministri përgjegjës për financat, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëposhtëm për aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin për kontabilitetin.
2	SKK 13 është i krahasueshëm me Seksionin 34 <i>Aktivitetet e Specializuara</i> të SNRF për NVM (2015). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM-të (2015) është dhënë në paragrafin 31. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 13 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike raportuese, siç kërkohet në Ligjin për kontabilitetin.
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 64 deri 68 të SKK 1.
	FUSHA E ZBATIMIT
4	Ky Standard do të zbatohet për: (a) aktivet biologjike, <i>përfshirë të gjitha aktivet biologjike, përveç tokave të përdorura për veprimtari bujqësore dhe prodhimin bujqësor, i cili kontabilizohet si inventar që nga momenti i përfimit; dhe</i> (b) marrëveshjet koncesionare.
	AKTIVET BIOLOGJIKE
	Përkufizimet kryesore
5	Më poshtë jepen përkufizimet e termave kryesore të përdorura në këtë standard: - <u>Aktiviteti bujqësor</u> është menaxhimi nga ana e një njësie ekonomike i transformimit biologjik të aktiveve biologjike në prodhim bujqësor për shitje ose në aktive të tjera biologjike. - <u>Prodhimi bujqësor</u> është prodhimi i përfutur nga aktivet biologjike të njësisë ekonomike. - <u>Aktivi biologjik</u> është një kafshë e gjallë ose bimë. - <u>Transformimi biologjik përfshin</u> proceset e rritjes, shndërrimit, prodhimit dhe mbarështimit që sjellin ndryshime cilësore e sasiore në aktivin biologjik.
	Politikat kontabël për aktivet biologjike
6	Një njësi ekonomike që zbaton këtë standard sepse kryen aktivitet bujqësor, duhet të përcaktojë politikën e saj kontabël për çdo klasë të aktiveve biologjike si më poshtë: (a) Njësia ekonomike duhet të përdorë modelin e vlerës së drejtë në paragrafët 9-12 për ato aktive biologjike për të cilat vlera e drejtë është menjëherë e përcaktueshme pa kosto apo përpjekje të tepërta; (b) Njësia ekonomike duhet të përdorë modelin e koston në paragrafët 13-14 për gjithë aktivet e tjera biologjike. Njësitë e vogla ekonomike inkurajohen por nuk janë të detyruara në zbatimin e pikës (a) të këtij neni. Këto njësi ekonomike përdorin modelin e koston për të gjitha aktivet e tyre biologjike.
	Njohja fillestare
7	Një njësi ekonomike duhet të njohë një aktiv biologjik ose një produkt bujqësor vetëm kur: (a) njësia ekonomike kontrollon aktivin biologjik / produktin bujqësor si rezultat i ngjarjeve të kaluara; (b) është e mundur që në njësinë ekonomike të hynë përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me aktivin biologjik/ produktin bujqësor; dhe (c) vlera e drejtë ose kosto e aktivit biologjik / produktit bujqësor mund të matet në mënyrë të besueshme pa kosto ose përpjekje të tepërta.
8	Njohja e aktiveve biologjike bëhet zakonisht në momentin e blerjes. Njohja bëhet gjithashtu kur aktivet biologjike gjenerohen / krijohen nga aktivet ekzistuese. Prodhimi bujqësor, i pandarë (pavjelur, pakorrur, palindur, paqethur, etj) nga një aktiv biologjik, nuk njihet si aktiv më vete.
	MATJA DHE VLERËSIMI I MËPASHHËM
	Matja-modeli i vlerës së drejtë

9	Një njësi ekonomike duhet të masë një aktiv biologjik në njohjen e tij dhe në çdo datë raportimi me vlerën e drejtë të tij minus kostot për shitje. Ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot për shitje duhet të njihen në fitim ose humbje.
10	Produktet bujqësore të përfutuara nga aktivet biologjike të një njësie ekonomike, duhet të maten në njohje me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes në momentin e përfutimit. Kjo vlerë e matur përbën koston në datën e përfutimit, kur zbatohet SKK 4 <i>Inventarët</i> .
11	Në përcaktimin e vlerës së drejtë, një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë si vijon: (a) Nëse ekziston një treg aktiv për aktivin biologjik ose produktet bujqësore në gjendjen dhe vendndodhjen e tij aktuale, çmimi i kuotuar në këtë treg është baza e përshtatshme për përcaktimin e vlerës së drejtë të atij aktivi. Nëse një njësi ekonomike ka akses në tregje të ndryshme të aktiveve, njësia ekonomike duhet të përdorë çmimin e tregut ku ai pret të shesë. (b) Nëse nuk ekziston ndonjë treg aktiv, një njësi ekonomike përdor një ose më shumë nga sa më poshtë, kur janë të disponueshme, në përcaktimin e vlerës së drejtë: (i) çmimin më të fundit të transaksionit të tregut, duke u siguruar që nuk ka asnjë ndryshim domethënës në rrethanat ekonomike ndërmjet datës të këtij transaksioni dhe datës së raportimit; (ii) çmimet e tregut për aktivet e ngjashme të rregulluara për të reflektuar diferencat; dhe (iii) referencat e sektorit, p.sh., vlera e një druri frutor e shprehur në çmim eksporti dhe vlera e bagëtive e shprehur në kilogramë mish. (c) Në disa raste, burimet e informacionit të listuar në pikat (a) ose (b) mund të sugjerojnë konkluzione të ndryshme për vlerën e drejtë të një aktivi biologjik ose një produkti bujqësor. Një njësi ekonomike merr në konsideratë arsyet e këtyre diferencave për të arritur në vlerësimin më të besueshëm të vlerës së drejtë brenda një game relativisht të ngushtë të vlerësimeve të arsyeshme. (d) Në disa rrethana, vlera e drejtë mund të jetë menjëherë e përcaktueshme pa kosto apo përpjekje shtesë megjithëse çmimet ose vlerat e përcaktuara të tregut nuk janë të disponueshme për një aktiv biologjik në gjendjen e tij aktuale. Një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse vlera aktuale e flukseve monetare neto të pritshme nga aktivi e skontuar me një normë të caktuar aktuale tregu, rezulton në një matje të besueshme të vlerës së drejtë.
12	Zakonisht njësia ekonomike bën shpenzime gjatë gjithë jetës së dobishme të një aktivi biologjik. Këto shpenzime kontabilizohen dhe përfshihen si pjesë e vlerës kontabël të aktiveve biologjike, vetëm nëse ato i plotësojnë kriteret e njohjes si aktiv.
	Matja – modeli i koston
13	Njësia ekonomike mat me kosto minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi i akumuluar, ato aktive biologjike vlera e drejtë e të cilëve nuk është menjëherë e përcaktueshme, pa kosto apo përpjekje shtesë.
14	Njësia ekonomike mat produktet bujqësore të siguruar nga aktivet e saj biologjike me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes në momentin e përfutimit. Një matje e tillë përbën koston e produktit bujqësor në datën e matjes.
	Zhvlerësimi i aktiveve biologjike të mbajtura me kosto
15	Aktivitet biologjike, të mbajtura me modelin e koston, i nënshtrohen testit për zhvlerësim në çdo datë raportimi të pasqyrës së pozicionit financiar.
16	Shuma e zhvlerësimit duhet të përcaktohet zë për zë. Në rastet kur një vlerësim i tillë nuk është praktik, zhvlerësimi duhet të matet për një grup zërash të ngjashëm, ose që kanë lidhje me njëri-tjetrin. Zvogëlimi duhet të marrë parasysh kostot e përllogaritura për përfundimin dhe shitjen e produkteve, por nuk duhet të përfshijë fitimin që do të krijohet në fazat e mëvonshme të prodhimit.
17	Një zvogëlim, i bërë në një periudhë kontabël të mëparshme, duhet të anulohet në ato raste kur kushtet, mbi bazën e të cilave është bërë zvogëlimi, nuk ekzistojnë më.
	Çregjistrimi
18	Aktivitet biologjike çregjistrohen atëherë kur ato shiten. Njësia ekonomike duhet t'i çregjistrojë aktivet biologjike edhe në ato raste kur ato nuk kanë më vlerë ekonomike për të ardhmen (skartohen ose ngordhin).
	Paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës të aktiveve biologjike
19	Aktivitet biologjike duhet të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar. Ndryshimet në vlerën e aktiveve biologjike paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
	MARRËVESHJET KONCESIONARE
	Koncesionet e shërbimeve
20	Një marrëveshje koncesionare e shërbimeve është një marrëveshje ku një qeveri ose një organ tjetër i sektorit publik (koncesiondhënësi) kontraktton një operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivet e infrastrukturës së koncesiondhënësit si rrugë, ura, tunele, aeroporte, rrjete të shpërndarjes së energjisë, burgje apo spitale. Në këto marrëveshje, koncesiondhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivet, kujt duhet t'ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënës në aktive në fund të afatit të marrëveshjes.
21	Ka dy kategori kryesore të marrëveshjeve koncesionare të shërbimeve: (a) Në njërin, operatori merr një aktiv financiar—një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të marrë një shumë specifike ose të përcaktueshme fluksesh monetare

	<p>ose një aktiv tjetër financiar nga qeveria në këmbim të ndërtimit ose përmirësimit të një aktivi të shërbimit publik dhe më pas duke përdorur dhe mirëmbajtur aktivin për një periudhë kohe të specifikuar. Kjo kategori përfshin garanci nga qeveria për të paguar për çdo mungesë ndërmjet shumave të marra nga përdoruesit e shërbimit publik dhe shumave të specifikuara apo të përcaktueshme.</p> <p>(b) Në tjetrën, operatori merr një aktiv jo-material—një të drejtë tarifimi për përdorimin e një aktivi të sektorit publik që ai ndërton ose përmirëson dhe më pas e përdor dhe e mirëmban për një periudhë kohe të specifikuar. Një e drejtë për t'i tarifuar përdoruesit nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të marrë mjete monetare sepse shumat janë të kushtëzuara në masën në të cilën publiku përdor shërbimin.</p> <p>Ndonjëherë, një kontratë e vetme mund t'i përmbajë të dyja llojet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në masën që qeveria i ka dhënë një garanci të pakushtëzuar të pagesës për ndërtimin e aktivit të sektorit publik, operatori ka një aktiv financiar; - në masën që operatori duhet të mbështetet tek publiku për përdorimin e shërbimit në mënyrë që të përftojë pagesën, operatori ka një aktiv jo-material.
	Modeli i aktivit financiar
22	Operatori duhet të njohë një aktiv financiar në masën që ai ka një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të marrë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar nga koncesiondhënësi për shërbimet e ndërtimit. Operatori duhet të masë aktivin financiar me vlerën e drejtë. Më tej, ai duhet të ndjekë SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i> .
	Modeli i aktivit jomaterial
23	Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licensën) për t'i tarifuar përdoruesit e shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivit jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK5 <i>Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale</i> .
	Të ardhurat operative
24	Operatori i një marrëveshje koncesionare të shërbimeve duhet që për shërbimin që ai kryen, të njohë, masë dhe deklarojë të ardhurat në përputhje me SKK 8 <i>Të Ardhurat</i> .
	Paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës të marrëveshjeve koncesionare
25	Aktivet dhe detyrimet që krijohen nga marrëveshjet koncesionare të shërbimeve dhe të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me to do të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në përputhje me kërkesat e SKK 2 <i>Paraqitja e pasqyrave financiare</i> .
	SHËNIMET SHPJEGUESE
	Shënimet shpjeguese për aktivet biologjike
	Aktivet biologjike të mbajtura me vlerë të drejtë
26	<p>Në pasqyrat financiare duhet të jepet informacioni i mëposhtëm, në lidhje me aktivet biologjike të matura me vlerën e drejtë:</p> <p>(a) një përshkrim të çdo klase të aktiveve të saj biologjike;</p> <p>(b) metodat dhe supozimet domethënëse të përdorura në përcaktimin e vlerës së drejtë të çdo kategorie të produkteve bujqësore në momentin e përfutimit dhe çdo kategorie të aktiveve biologjike;</p> <p>(c) një rakordim të ndryshimeve në vlerën kontabël të aktiveve biologjike ndërmjet fillimit dhe fundit të periudhës aktuale. Rakordimi duhet të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) fitimin ose humbjen që lind nga ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot e shitjes; (ii) rritjet që rezultojnë nga blerjet; (iii) rëniet që rezultojnë nga vjelja; (vi) ndryshime të tjera
	Aktivet biologjike të mbajtura me kosto
27	<p>Në pasqyrat financiare duhet të jepet informacioni i mëposhtëm, në lidhje me aktivet biologjike të matura me modelin e koston:</p> <p>(a) një përshkrim të çdo klase të aktiveve biologjike;</p> <p>(b) një shpjegim se përse vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme;</p> <p>(c) metodën e përdorur të amortizimit;</p> <p>(d) jetët e dobishme ose normën e përdorur të amortizimit;</p> <p>(e) vlerën kontabël bruto dhe amortizimin e akumuluar (së bashku me humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë) në fillim dhe në fund të periudhës.</p>
	Shënimet shpjeguese për marrëveshjet koncesionare
	Modeli i aktivit financiar
28	Një njësi ekonomike që zbaton kërkesat e këtij Standardi në lidhje me marrëveshjet koncesionare të shërbimeve që rezultojnë në aktiv financiar, do të japë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara nga SKK 3 <i>Instrumentet Financiarë</i> , si dhe nga SKK 8 <i>Të Ardhurat</i> .

	Modeli i aktivitet jomaterial	
29	Një njësi ekonomike që zbaton kërkesat e këtij Standardi në lidhje me marrëveshjet koncesionare të shërbimeve që rezultojnë në aktiv jomaterial, do të japë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara për aktivet afatgjata jomateriale nga SKK 5 <i>Aktivitet afatgjata materiale dhe aktivitet afatgjata jomateriale</i> , si dhe nga SKK 8 <i>Të Ardhurat</i> .	
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	
30	SKK 13 <i>Aktivitet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare</i> , përditësuar në vitin 2023, do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 01.01.2025. Kërkesat e SKK 13 (2023) do të zbatohen në prospektivë.	
	TABELA KRAHASUESE	
31	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM (2015). Paragrafët janë konsideruar si korresponduese nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje pavarësisht nga fakti që seksionet e referuara mund të kenë ndryshime.	
	Paragrafët e SKK 13	Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2015
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 34.1
	Paragrafi 5	Asnjë
	Paragrafi 6	Sek 34.2
	Paragrafi 7	Sek 34.3
	Paragrafi 8	Asnjë
	Paragrafi 9	Sek 34.4
	Paragrafi 10	Sek 34.5
	Paragrafi 11	Sek 34.6
	Paragrafi 12	Asnjë
	Paragrafi 13	Sek 34.8
	Paragrafi 14	Sek 34.9
	Paragrafi 15	Asnjë
	Paragrafi 16	Asnjë
	Paragrafi 17	Asnjë
	Paragrafi 18	Asnjë
	Paragrafi 19	Asnjë
	Paragrafi 20	Sek 34.12
	Paragrafi 21	Sek 34.13
	Paragrafi 22	Sek 34.14
	Paragrafi 23	Sek 34.15
	Paragrafi 24	Sek 34.16
	Paragrafi 25	Asnjë
	Paragrafi 26	Sek 34.7
	Paragrafi 27	Sek 34.10
	Paragrafi 28	Asnjë
	Paragrafi 29	Asnjë
	Paragrafi 30	Asnjë
	Paragrafi 31	Asnjë